



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva Obrazovanja Nauke i
Tehnologije-Ministry of Education Science &Technology*

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV
ZBATIMI I PLANIT DHE PROGRAMIT PËR ARSIMIN PROFESIONAL
LËMI: SHËNDETËSI, PËR NIVELIN E PARË (X, XI, XII)**

**NUMËR: 26/2009
DATË: 02.09.2009**

Në mbështetje të nenit, 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,të, nenit 6.1 paragrafi (d) të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, nenit 6, 8, 11 të Ligjit mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional si dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

**Neni 1
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është zbatimi i planit dhe programit mësimor për shkollat profesionale, klasën e dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë s i rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit fillor dhe të mesëm.

**Neni 2
Planprogrami**

1. Plani dhe programi i ri për nivelin e parë (kl. X, XI , XII) lëmi: *Shëndetësi, profilet: asistent i stomatologjisë, asistent i farmacisë, teknik i dhëmbëve si dhe profilet për kl.XIII*


për profilet: ndihmësinfermier i përgjithshëm, ndihmësinfermier i mamisë, ndihmësinfermier i pediatrikë i është bashkangjitur këtij Udhëzimi administrativ.

Neni 3
Zbatueshmëria

1. Me zbatimin e planit dhe programit të klasës së dhjetë, zëvendësohen planet dhe programet e deritashme të klasës së 10, 11 dhe 12.

Neni 4
Hyrja në fuqi

1. Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me fillimin e vitit shkollor 2009/2010.


Enver Hoxhaj, ministër